



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.60/01-14615/26
Kaçanik, 26.06.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VI (gjashtë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2026, mbajtur me 26.06.2026.

Mbledhja u mbajtë në katin e dytë të objektit të administratës së komunës, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës nga KPF ishin 7 anëtarët: Selajdin Troni, Bashkim Krasniqi, Lejla Muhaxheri Çaka, Kadrije Lika Troni, Ernesta Krasniqi, Ardita Rrahmani, Kjani Zeneli. Në ndërkohë 2 anëtare, Kadrije Lika Troni dhe Ernesta Krasniqi e lëshuan mbledhjen.

Nga Ekzekutivi në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komuës -Sabedin Vishi, Nënkrjetari i Komunës - Xhelal Dema si dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale.

Mbledhjen e udhëheqi, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfite Malsiu, ZLPPK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi, e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të Rregullt të KPF të datës 26.06.2026, me këtë

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029;
3. Propozim Vendim për Riorganizimin e Gjendjes Civile, përkatësish Shuarjen e Zyrave të vendit;
4. Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2025.

Pika me nr. 4, nuk ishte në rend pune, e njëjta u propozua në mbledhje. Materiali për këtë pikë u dërgua diku një orë para mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit: Për sqarime të nevojshme për pikën 4, fjalën e ka drejtori i DBF-Valdrin Dogani.

z. Valdrin Dogani: Sqaroj se mbledhja e KPF është përgatitur me 17.06.2026, ndërkaq Raporti i Auditorit ka ardhur me vonë. Zyrtari për punë të KK ka qenë në pushim vjetor për me dërgua këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin :

znj. Kadrije Lika Troni: Kur një punëtor shkon në pushim vjetor, duhet me ekzistuar zëvendësimi.

z. Valdrin Dogani: Raporti i Auditorit ka ardhur me vonesë, kështuqë nuk është faji jonë.

Kryetari i Komunës: Nëse jeni të pajtimit e shqyrtojmë sot Raportin e Auditorit, nëse jo e lëmë për mbledhjen vijuese të KPF. Në mbledhjen vijuese ka me qenë në shqyrtim, Plan i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas Raportit të Auditorit të ZKA, për vitin 2025.

znj. Ardita Rrahmani: Unë jam me shqyrtuar sot Raportin e Auditorit dhe me përcjallë për KK, pasi ne nuk mundem me ndryshuar asgjë në raport, pasi raporti është një lloj informate. Për hera tjera materiali i çdo pike me na ardhur me kohë. Sa i përket çështjes që materiali na ka ardhur me vonesë, LVV ka propozuar si pikë subvencionimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, me hyrë në rend pune në mbledhje, dhe pa material.

z. Bashkim Krasniqi: Si raport mundemi me diskutuar. Kjo është një lloj infotmate, ne nuk e kemi hartuar dhe nuk mundemi me ndryshuar asgjë në këtë raport. Unë jam i pajtimit të përcjellim për KK këtë raport, në mbledhje e kuvendit i japim vërejtjet tona.

znj. Ernesta Krasniqi: Ne e kemi ngritur kërkesën për me i mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta, por kur e kemi kuptuar se është vonë, e kemi lënë atë çështje për me vonë. Mendoj se është vonë, vetëm një orë para mbledhjes me na ardhur materiali me diskutuar Raportin e Auditorit.

znj. Kadrije Lika Troni: Ju drejtor theksuat se materiali na ka ardhur pasi ka shkuar në pushim zyrtarja e KK.

z. Valdrin Dogani: Nuk thashë ashtu. Unë Raportin e Auditorit e kam përcjellë me kohë pasi e kam pranuar. Ia kam përcjellë Kryesuesit të KK dhe Zyrës së KK.

znj. Ardita Rrahmani: Materiali nuk është shumë i gjerë për mos me pasur mundësi me përpunuar për mbledhje të KK. Unë tani sa e mora materialin, me vonë se ju dhe nuk po e bëjë problem këtë punë.

znj. Kadrije Lika Troni: Ligji për Vetëqeverisje Lokale e përcakton afatin e dërgimit të materialit për mbledhje të rregullta, 7 ditë pune para mbledhje, 2 ditë për ndonjë pikë që shtohet, me përjashtim të çështjeve urgjente që mund të shtohen aty për aty. Kur punëtori është në pushim, duhet me pasur zëvendësimin. Ne nuk është puna vetëm me ngritur dorën, ne duhet me lexuar materialin.

Kryesuesi i Kuvendit: Prej ministrie kur po kthehet ndonjë pikë, po duhet me shqyrtuar, pavarësisht afatit të dërgimit të materialit. Besoj se ka hapësirë me u shqyrtuar në KK, se janë edhe 2 ditë në dispozicion. Kush është për rendin e punës?

Kryetari i Komunës: Edhe pika 3 duhet të hiqet pa u aprovua rendi i punës.

znj. Ernesta Krasniqi: Për cilën pikë është fjala?

znj. Kadrije Lika Troni: Atëhere ne e lëshojmë mbledhjen.

Kryesuesi i Kuvendit: Doni me ndejur në mbledhje, rrini. Nëse nuk doni, ecni.

znj. Ernesta Krasniqi: Kryesues, lexoni rregulloren, se kjo çasje e juaja kështu, nuk është në rregull.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk merrem me juve fare. Ju vazhdimisht na keni quajtur me lloj lloj etiketimesh.

znj. Kadrije Lika Troni: A e dëgjuat çka na tha kryesuesi?

znj. Ernesta Krasniqi: Kërkoj të shkruhet në procesvrrbal.

znj. Kadrije Lika Troni: Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të tërheqë fjalën. Ndërkaq nga Kryetari i Komunës kërkoj të reflektoj.

znj. Ardita Rrahmani: A ka mundësi 5 minuta pauzë. Uluni njëherë, pastaj e shihni sesi e kundërshtojmë atë fjalë, nëse e ka thënë kryesuesi, se unë nuk e kam dëgjuar.

Me këtë rast, dy anëtarët nga LIT, Kadrije Lika Troni dhe Ernesta Krasniqi e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi i Kuvendit: Dy anëtarët e LVV e lëshuan mbledhjen. Vazhdojme ku mbetëm.

znj. Ardita Rrahmani: Kryesues, ju po bini pre e provokimeve të tyre. Për hiç gjë, mundeni me u bërë kryelajm.

Kryesuesi i Kuvendit: Me këta njerëz nuk ka gjuhë tjetër. Nëse e kanë nënshkruar regjistrin për kompensimin e mëditjeve, kërkoj nga zyrtarja e KK të sjellë një regjistër tjetër për nënshkrime.

Zyrtarja e KK: Regjistri është nënshkruar. Nuk ka nevojë me sjellë regjistër tjetër. Ne raport mundet me u potencuar se e kanë lëshuar mbledhjen dy anëtarët e KPF nga LVV.

Kryetari i Komunës: Problemi u ngrit atëherë kur unë i thashë Kryesuesit të Kuvendit se duhet me hequr pikën 3, para se me u aprovua rendi i punës.

Kryesuesi i Kuvendit: Mua zyrtarja e KK me tha me hequr pikën 3, kur të vijmë të shqyrtimi i saj. Atëherë kërkoj që të hiqet pik 3.

Kryetari i Komunës: Pika 3 duhet të hiqet para miratimit të rendit të punës, ndërkaq DAP do të del me Propozim Vendim të veçantë në një mbledhje tjetër për shuarjen e Zyrës së Vendit në Ivajë.

Kryesuesi i Kuvendit: Për pikën 3, fjalën e ka drejtoresha e DAP Urata Sopa.

znj. Urata Sopa: Sa i përket pikës për riorganizminin e Sherbimit Civil, përkatësisht shuarjen e disa nga Zyrat e vendit, kërkoj që kjo pikë të hiqet, pasi që sipas vlerësimeve që i

kemi bërë, raporteve që i kemi gjeneruar, del se nevojat e qytetarëve për shërbime vazhdojnë edhe tutje, dhe është një formë me e qasshme për ta me marrë shërbime në lokalitetet ku jetojnë. Andaj jemi pajtuar që Zyrat e vendit të propozuara me u shuar, mos të shuhen, por të vazhdojnë tutje funksionimin e tyre, në mënyrë që çdo vendim i yni që e marrim, të jetë në të mirë të qytetarëve tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmni: Nuk e kam të qartë, po mbyllet shkolla e nuk po mbyllet Zyra e Vendit në Ivajë Cila është logjika e kësaj?

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk kemi arritur ende aty.

znj. Ardita Rrahmani: Për këtë pikë është fjala. Mbyllet shkolla e nuk mbyllet Zyra e Vendit.

z. Kiani Zeneli: Mirë që po hiqet pika 3 e nuk po po mbyllet Zyrat e Vendit, pasi kanë shërbime këto zyra, si ajo në Gllloboçicë dhe Zyrat tjera të vendit të propozuara për shuarje. Ndërkaq për Zyrën e Vendit në Ivajë jam me u mbyllë, se nuk po kanë shërbime, popullata janë shpërngulur masivisht në Kaçanik të Vjetër. Zyrat e Vendit në Dubravë, Doganaj kanë shërbime. Me vjen mirë që drejtoresha e ka bërë një raport që mos me i mbyllë këto Zyra të Vendit.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimin për heqjen e pikes 3, e shtroj ne votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 5. Konstatohet se pika 3. Propozim Vendim për Riorganizimin e Gjendjes Civile, përkatësish Shuarjen e Zyrave të vendit, hiqet nga rendi i punës.

Pika 3 u hoq nga rendi i punës. Atëherë edhe Propozimin për shtimin e pikës: Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2025 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 5. Konstatohet se në rend pune shtohet pika: Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2025.

Atëhere a jeni te punojmë me këtë rend pune

Njëzëri u pajtuan të gjithë. Prezentë 5. Konstatohet se në këtë mbledhje KPF do të punoj me këtë rend pune:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;

2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029;

3 Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2025.

Kalojmë në pikën e parë:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;

A ka kush ndonjë vërejtje? Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 5. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Procesverbalin nga mbledhja e pestë (5) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 26.05.2026.

Kalojme në pikën dytë:

2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029;

E hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo pikë të kalojë në procedurë të KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Prezetë 5. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029. KBAK I

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim

Kalojmë në pikën e fundit:

3. Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2025:

E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 5. Konstatohet se KPF aprovoj Raportin e Auditorit dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Diçka tjetër për këtë mbledhje nuk ka, atëherë e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 11:40.

Deri në fund të mbledhjes ishin 5 anëtarë, ndërkaq 2 anëtarët nga LVV e lëshuan mbledhjen. Mbledhja e gjashtë (6) e rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 29.06.2026(e hënë) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfirë Malsiu

Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni

